



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-085

Prishtinë, më 27 mars 2017, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 27 MARS 2017

Në mbledhje morën pjesë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Slobodan Petroviq dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Zenun Pajaziti, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Pal Lekaj, Slavko Simiq, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,
Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu dhe
Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e drejtoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Nënkryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e nënkryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme
3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës dhe
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

* * *

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 8 mars 2017

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 8 mars 2017.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit me pikat e papërfunduara nga seancat plenare, të mbajtura më: 9, 14, 15, 27 shkurt dhe 2, 9 dhe 10 mars 2017.

Nënkryetari i Kuvendit, z. **Sabri Hamiti**, propozoi që Kuvendi t'i mbajë dy seanca të veçanta: njëra me pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme dhe me pjesën legislative, - shqyrtimi i projektligjeve, dhe tjetra me tri pikat e përhershme dhe me interpelancë, debate parlamentare dhe shqyrtimin e raporteve.

Të gjithë të pranishmit u pajtuan me propozimin e nënkryetarit të Kuvendit.

Kryesia, pasi diskutoi për përgatitjet e nevojshme, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi gjatë kësaj jave t'i mbajë dy seanca plenare dhe atë si në vijim:

Më 30 mars 2017, me fillim në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-137 për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor,
2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor ndërmjet Kosovës, Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë,

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervës rregulluese ndërmjet operatorit të sistemit të transmetimit OST sh. a. dhe operatorit të sistemit, të transmissionit dhe tregut-KOSTT sh. a.,
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-157 për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit të Projektit për sigurinë e ujit dhe mbrojtjen e kanalit, e nënshkruar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmarrjet sociale,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L- 074 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovë,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-138 për kompleksin memorial “Adem Jashari” në Prekaz,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-142 për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore,
9. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-091 për mbrojtjen nga zhurma,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
14. Votimi i Propozim-rezolutës në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”,
15. Votimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
16. Zgjedhja e një (1) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komunitetit serb.

Më 31 mars 2017, me fillim në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Propozim - Programit të Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2017,

5. Interpelanca e ministrit Blerand Stavileci, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, në lidhje me Kontratën e privatizimit të Kompanisë së Distribuimit të Energjisë Elektrike,
6. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/ L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë,
7. Zgjedhja e një (1) anëtarit të Komisionit të Pavarur për Medie,
8. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, e mbështetur edhe nga 9 deputetë tjerë nënshkrues, në lidhje me moszbatimi e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga Qeveria e Republikës së Kosovës,
9. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetëve Bekim Haxhiu dhe Xhevahire Izmaqi, të mbështetur edhe nga 8 deputetë tjerë nënshkrues, në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëtorëve në Kosovë.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

16. Njoftimi lidhur me mbledhjen e 3-të të përbashkët të Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim, BE - Kosovë, e cila do të mbahet në Prishtinë, prej 20-21 prill 2017

Kryesia, pasi u njoftua lidhur me çështjen e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të dala lidhur me mbledhjen e 3-të të përbashkët të Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim, BE-Kosovë, e cila do të mbahet në Prishtinë, prej 20-21 prill 2017.

* * *

Kryesia, me propozim të nënkryetarit të Kuvendit, z. Haliti, 17 pikat e tjera të rendit të ditës të kësaj mbledhjeje i shtyu për mbledhjen e radhës.

Në fund të mbledhjes, Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Kosovës, z. Ismet Krasniqi, i njoftoi anëtarët e Kryesisë për vdekjen e zyrtarit të Administratës së Kuvendit në vendin e punës, Luan Balidemaj.

Kryesia, me propozimin e sekretarit, vendosi që më 28 mars 2017 të mbahet një mbledhje komemorative, si dhe t'i mbulojë shpenzimet e varrimit për të ndjerin.

Nënkryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 13:20 minuta.

Nënkryetari i Kuvendit:
Xhavit HALITI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale